

Projekt: “Zhvillim dhe implementim i indeksit të shëndetit në ndotjen ndërkufitare të ajrit” (shkurtesa „TRAP“)

Lëshimi në përdorim i stacionit të matjes për cilësinë e ajrit.

Ceremoni e vogël zyrtare ishte e organizuar për shënimin e fillimit zyrtar të punës së stacionit në Gjevgjeli ku ministri i mjedisit jetësor i planifikimit hapësinor, Z. Naser Nuredini, ministri i vetëqeverisjes lokale, Z. Goran Milevski, ambasadori i EU, z. Dejvid Gir, dhe kryetari i komunës së Gjevgjelisë, Z. Sasho Pockov, ju drejtuan të pranishmëve.

Për realizimin e këtij projekti, Bashkimi evropian nëpërmjet Programit IPA për bashkëpunim ndërkombëtar e financoi projektin në vlerë të përgjithshme prej thujse një milionë euro për... [lexo më shumë].

Më datën 17. nëntor 2020, komuna Gjevgjeli fitoi stacion të ri për ndjekjen e cilësisë së ajrit. Stacioni mbikëqyrës është furnizuar nëpërmjet projektit „Zhvillimi dhe implementimi i indeksit të ndotjes ndërkufitare të ajrit në shëndetësi” të bashkëfinancuar në



kuadër të programit IPA “Programi për bashkëpunim ndërkufitar Greqi – Republika e Maqedonisë së Veriut 2014-2020”. Ministria e mjedisit dhe planifikimit jetësor si partner përdorues në këtë projekt ishte përgjegjëse për zbatimin e këtij aktiviteti dhe furnizimi të stacionit të monitorimit në Gjevgjeli dhe instrumentet për ndjekjen e stacionit tashmë të instaluar Manastir 1. Furnizimi i

pajisjeve përfshin një stacion automatik për ndjekjen e cilësisë së ajrit.

Stacioni i ri ka analizatorë për ndjekje të Dioksidit të squfurit (SO₂), oksidet e azotit (NO_x, NO₂), monoksid karboni (CO), ozon (O₃), grimca (PM_{2.5} dhe PM₁₀). Ky stacion i ri e plotësin rrjetin e vazhdueshëm për mbikëqyrjen e



cilësisë së ajrit në vend.

Përveç furnizimit të stacionit për mbikëqyrje, në kuadër të projektit zbatohen edhe një sërë aktivitetesh të tjera. Domethënë, në kuadër të këtij programi, është kryer zëvendësim i plotë i të gjitha

instrumenteve në stacionin matës Manastir 1, dhe janë furnizuar instrumente për matjen e grimcave PM_{2,5}, për stacionin e matjes Manastir 1 dhe këtë në Gjevgjeli. Gjithashtu, janë furnizuar dy standarde / mostra referente automatike me vëllim të ulët për matjen e grimcave të suspenduara (PM₁₀ dhe PM_{2,5}) dhe të vendosura në afërsi të stacionit të matjes Manastir 1 dhe Gjevgjeli.



Në mënyrë plotësuese, projekti do ta vlerësojë ndikimin e cilësisë së ajrit mbi shëndetin e njerëzve në rajonin ndërkufitar, do të zhvillojë indeks shëndetësor, do ta përforcojë bashkëpunimin ndërkufitar nëpërmjet organizimit të trajnimit tematik, do të përgatisë dhe do të zbatojë më shumë aktivitete për ndërgjegjësimin publik të qytetarëve. Përveç Ministrisë, partnerë të tjerë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbatimin e projektit janë Qendra për ndryshime klimatike – Gjevgjeli dhe tre partnerë nga Republika e Greqisë (Qendra e mjedisit jetësor të Maqedonisë Perëndimore, Komuna Follorinë dhe Korniza Evropiane rajonale për Bashkëpunim).

Për realizimin e këtij projekti, Bashkimi Evropian nëpërmjet Programit IPA për bashkëpunim ndërkufitar e financoi projektin në vlerë të përgjithshme prej thujse një milionë euro për të dyja shtetet, dhe bashkëfinancimi kombëtar në shumën prej 15 për qind ishte e siguruar nga Ministria e Vetëqeverisjes lokale.

